



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

RREGULLORJA
PËR RENDIN DHE QASJEN E MEDIAVE DHE
TË PUBLIKUT NË PUNËN E KUVENDIT TË KOSOVËS

Prishtinë, prill 2011

Kryesia e Kuvendit,

Në bazë të nenit 41, paragrafi 6, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2011, me propozim të sekretarit, e nxjerr këtë

RREGULLORE
PËR RENDIN DHE QASJEN E MEDIAVE DHE
TË PUBLIKUT NË PUNËN E KUVENDIT TË KOSOVËS

KREU I (DISPOZITAT THEMELORE)

Rregulla 1 (Qëllimi)

Dispozitat e kësaj Rregulloreje e përcaktojnë qasjen dhe praninë: e mediave, të shoqatave të qytetarëve, të organizatave joqeveritare, të vizitave të organizuara, , në Kuvendin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), të organeve dhe të trupave të punës.

Rregulla 2

Puna e Kuvendit, e organeve dhe trupave të punës **(seanca plenare, Kryesia dhe komisionet parlamentare)** është publike dhe transparente.

KREU II (PUNA PUBLIKE)

Rregulla 3 (Prania në seancën plenare të Kuvendit)

1. Përfaqësuesit e shoqatave të qytetarëve dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare mund ta përcjellin, si vëzhgues, seancën plenare të Kuvendit, prej lozhës së sallës kryesore të Kuvendit.
2. Përcjelljen e seancës plenare, përfaqësuesve nga paragrafi 1 i kësaj rregulle, ua lejon Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, në bazë të kërkesës së bërë me shkrim, së paku tri ditë pune para mbajtjes së seancës.
3. Leja për përcjelljen e seancës plenare jepet për çdo seancë, përveç organizatave joqeveritare, që e mbështesin punën e Kuvendit, të cilave u jepet leje afatgjatë, në përputhje me kohëzgjatjen e programit të mbështetjes.
4. Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun e harton listën e atyre që e përcjellin seancën plenare, sipas radhës së paraqitjes së kërkesës.
5. Në rastet, kur numri i të paraqiturve për përcjelljen e seancës është më i madh se numri i ulëseve, Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun i

njofton, së paku një ditë para seancës, ata të që nuk mund ta përcjellin seancën plenare.

6. Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, për të gjitha aktivitetet në kuadër të kësaj rregulle, paraprakisht e merr pëlqimin nga sekretari i Kuvendit.

Rregulla 4

1. Lista e emrave të atyre, që lejohen ta përcjellin seancën plenare i dorëzohet sekretarit të Kuvendit dhe përgjegjësit të Shërbimit të Sigurisë në Kuvend, së paku një ditë para mbajtjes së seancës.
2. Përfaqësuesit, nga rregulla 3.1 e kësaj Rregulloreje, me rastin e hyrjes në ndërtesën e Kuvendit, duhet t'i paraqesin ID-të personale, të pajisen me ID-të e Kuvendit, t'u nënshtrohen masave të kontrollit nga Shërbimi i Sigurisë së Kuvendit dhe të sillen në përputhje me Rregullat e rendit në ndërtesën e Kuvendit.
3. Gjatë përcjelljes së seancës plenare, është i ndaluar çdo veprim, që e pengon punën e seancës, si: folja me zë të lartë, përdorimi i telefonave mobil, fotografimi, bartja e transparenteve e të tjera, që në çfarëdo mënyre bien ndesh me rendin në seancë plenare ose e pengojnë a e vështirësojnë punën e saj.

Rregulla 5

1. Sekretari i Kuvendit, përjashtimisht, mund ta lejojë përcjelljen e seancës plenare, edhe jashtë afateve të parapara në rregullën 3.2, në rastet e arsyeshme.
2. Sekretari i Kuvendit mund t'ia ndalojë përcjelljen e seancës plenare, për shkaqe sigurie, kujtudo nga të pranishmit, pa marrë parasysh se gjendet në listën e përcjellësve të seancës plenare.
3. Për rastet nga paragrafi 2, sekretari i Kuvendi do t'ia ofrojë arsyet me shkrim palës së përfshirë.

Rregulla 6 (Prania në mbledhjet e trupave të punës të Kuvendit)

1. **Gazetaret e akredituar**, përfaqësuesit e shoqatave të qytetarëve dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare mund t'i përcjellin: mbledhjet, dëgjimet publike dhe tryezat e rrumbullakëta të trupave të punës të Kuvendit nga ulëset e prapme ndihmëse të sallave të trupave të punës.
2. Përfaqësuesit, nga paragrafi 1 i kësaj rregulle, lejet për të qenë të pranishëm i marrin në Zyrën për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, pas kërkesës së paraqitur me shkrim, së paku dy ditë pune para mbajtjes së mbledhjes ose të formës tjetër të aktivitetit.
3. Lejet jepen për çdo mbledhje, përveç organizatave që e mbështesin Kuvendin, të cilave u lejohet prania në përputhje me kohëzgjatjen e programit.
4. **Gazetaret e akredituar**, përfaqësuesit e shoqatave të qytetarëve dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, në rastet kur nuk ka vende të

- mjaftueshme ose për ndonjë arsye tjetër, i njofton Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, së paku një ditë para mbledhjes.
5. Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun të gjitha aktivitetet në kuadër të kësaj rregulle i zhvillon në koordinim me sekretarin e Kuvendit dhe me udhëheqësit e trupave të punës të Kuvendit.
 6. Dispozitat e rregullës 4 dhe të rregullës 5 të kësaj Rregulloreje zbatohen, përshtatshmërisht edhe në rastet e përcjelljes së aktiviteteve të trupave të punës.

Rregulla 7 (Vizitat e organizuara në Kuvend)

1. Grupet e organizuara të qytetarëve mund ta vizitojnë Kuvendin e Kosovës, me qëllim të njohjes së përafërt me: historikun, punën dhe ambientet e Kuvendit.
2. Grupi mund të ketë më së shumti 30 persona.
3. Gjatë një dite mund të realizohen, më së shumti, dy vizita të grupeve të organizuara të qytetarëve.
4. Grupet e organizuara të qytetarëve, gjatë realizimit të vizitës, janë të detyruara t'u përmbahen rendit dhe rregullit në Kuvend.
5. Kërkesa për vizitën, që e përmban edhe qëllimin e vizitës, duhet t'i parashtrahet Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun pesë ditë para datës së vizitës.
6. Vizitën e lejon sekretari i Kuvendit. Sekretari i Kuvendit, për shkaqe sigurie, mund ta shtyjë lejimin e vizitës ose ta ndërpresë vizitën gjatë realizimit.

Rregulla 8

1. Individët dhe grupet e ndryshme studimore-krahasuese, të brendshme dhe të jashtme, mund ta vizitojnë, në mënyrë të organizuar, Kuvendin e Kosovës.
2. Kërkesa e shkruar, për vizitën nga paragrafi 1 i kësaj rregulle, duhet t'i parashtrahet Zyrës për Hulumtime dhe Bibliotekë shtatë ditë para vizitës.
3. Vizitën e lejon sekretari i Kuvendit pas konsultimeve të nevojshme me mekanizmat kompetentë.
4. Studiuesve u paraqiten materialet dhe të dhënat, që janë objekt i studimit, përveç atyre që janë të ndaluara me aktet e Kuvendit.
5. Studiuesit, për qëllime studimi, mund t'i shfrytëzojnë hapësirën dhe literaturën e Bibliotekës së Kuvendit të Kosovës.
6. Studiuesit janë të detyruar t'u përmbahen rendit dhe rregullit në Kuvend.

KREU III (TRANSPARENCA)

1. Kuvendi dhe trupat e punës

Rregulla 9 (Transmetimi dhe raportimi)

1. Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës e transmeton Radio Televizioni Publik i Kosovës (RTK).

2. Te gjithë mediat e akredituara kanë qasje në sinjalin e transmetimit të seancës plenare. Në ballkonin e seancës plenare, mediat mund të vendosin nga një kamerë gjatë kohëzgjatjes së seancës.
3. Kuvendi krijon hapësirë dhe kushte për mediat e akredituara për përcjelljen e seancës plenare.
4. Në rastet kur nuk ka hapësirë të mjaftueshme për të gjithë përfaqësuesit e mediave, përparësi u jepet përfaqësuesve të mediave elektronike. Në këto raste përfaqësuesit e mediave të shkruara mund ta ndjekin seancën nga salla e shtypit.
5. Në rastet, kur seanca është e mbyllur për publikun, Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun i njofton përfaqësuesit e mediave, nëse pas takimit do të jepet deklaratë publike.
6. Sipas kërkesës mediat e akredituara mund të pajisen me videoincizime të seancave plenare në CD nga shërbimet përkatëse të Kuvendit.
7. Transkriptet e takimeve të organeve dhe të trupave të punës të Kuvendit publikohen në faqen e internetit të Kuvendit.

Rregulla 10 (Filmimi dhe fotografimi)

1. Në fillim të çdo seance, pesëmbëdhjetë minutat e para, janë të rezervuar për xhirime dhe për fotografim, nga salla e seancës plenare ose nga ballkoni i sallës.
2. Seancat solemne, seancat e përkujtimit të datave të shënuara, mund të filmohen dhe të fotografohen gjatë tërë kohës.
3. Në rastet e betimit sigurohet kohë shtesë për filmim dhe për fotografim.
4. Kur mediat kërkojnë seancë fotografimi shtesë, Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun ia paraqet kërkesën sekretarit të Kuvendit. Në rastet kur kërkesa e mediave nuk miratohet, fotografitë e bëra nga Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, u shpërndahen falas të gjitha mediave të interesuara.
5. Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun i njofton rregullisht përfaqësuesit e mediave për seancat e fotografimit në ngjarjet e karakterit protokollar.
6. Nuk lejohen fotografimi dhe videoincizimet nga ulëset e deputetëve dhe nga tavolinat e tyre.
7. Nuk lejohen fotografimi dhe videoincizimet nga holli i Kuvendit të Kosovës.
8. Fotografitë dhe regjistrimet televizive nga Kuvendi mund të përdoren vetëm për të raportuar për punën e Kuvendit të Kosovës dhe nuk lejohen të përdoren për qëllime të tjera komerciale dhe propaganduese.
9. Rregullat 9 dhe 10 zbatohen të përshtatura edhe për mbledhjet e trupave të punës.

Rregulla 11 (Konferenca për shtyp)

1. Konferenca për shtyp thirret në emër: të kryetarit të Kuvendit, të nënkryetarit të Kuvendit, të kryetarit të komisionit parlamentar, të shefit të grupit parlamentar dhe të sekretarit të Kuvendit.
2. Deputeti me grup parlamentar mund të organizojë konferencë për shtyp në hapësirat e grupit të vet parlamentar. Ndërkaq, deputeti pa grup

parlamentar mund të organizojë konferencë shtypi, pas njoftimit të Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me publikun, së paku një ditë para mbajtjes së konferencës. Në këtë rast, deputeti në bashkëpunim me Zyrën, e cakton hapësirën dhe kohën e mbajtjes së konferencës.

3. Konferencën për shtyp, nga paragrafi 1 i kësaj rregulle, e organizon Kabineti i Kryetarit të Kuvendit dhe Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.
4. Materialet e konferencës për shtyp, pas konferencës, u shpërndahen gazetarëve.

Rregulla 12 (Deklarata publike)

1. Në rastet kur seanca plenare dhe mbledhja e trupit të punës janë të mbyllura për publikun, Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun organizon të jepet deklaratë publike, me ç'rast personat përgjegjës: kryetari i Kuvendit, nënkryetari i Kuvendit, kryetari i komisionit parlamentar, sekretari i Kuvendit, japin deklaratë para përfaqësuesve të mediave.
2. Deklaratat publike jepen në këndin për media, në hyrje të Kuvendit, në sallën e komisionit parlamentar ose të grupit parlamentar. Në rastet kur hapësirat e cekura më lart nuk janë të lira, deklaratat publike mund të bëhet në korridoret e ndërtesës së Kuvendit.
3. Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, i njofton përfaqësuesit e mediave, në kohën e duhur, për ndodhjen e deklaratës publike.

Rregulla 13 (Komunikata për shtyp dhe njoftimi)

1. Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun jep komunikatë për shtyp për ngjarjet, që ndodhin në Kuvend dhe për ngjarjet, që ndodhin jashtë Kuvendit, në të cilat marrin pjesë përfaqësuesit e Kuvendit.
2. Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun mund të japë komunikatë për shtyp, në raste të veçanta, për të raportuar për punën e organeve dhe trupave të punës të Kuvendit.
3. Zyra e përgatit dhe ua përcjell komunikatën mediave, nëpërmjet e-mailit ose duke i publikuar në faqen e internetit të Kuvendit. Komunikata plotësohet me fotografitë e publikuara në faqen e internetit të Kuvendit. Me kërkesë të mediave fotografitë mund të dërgohen me e-mail, me rezolucion të lartë.
4. Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun i njofton mediat e interesuara për mbajtjen: e seancës plenare, të mbledhjes së Kryesisë, të mbledhjes së komisionit parlamentar e të tjera.
5. Komunikata për shtyp dhe njoftimi për mbajtjen e mbledhjeve u shpërndahen nëpërmjet e-mailit të gjithë përfaqësuesve të mediave të akredituara dhe atyre që nuk janë të akredituara, por që janë të regjistruara në listën e njoftimeve.

Rregulla 14 (Intervista)

1. Organizimin për të dhënë intervistë kryetari i Kuvendit e bën përfaqësuesi për media në Kabinetin e kryetarit të Kuvendit.

2. Organizimin për të dhënë intervistë: nënkryetari i Kuvendit, kryetari i komisionit parlamentar, sekretari i Kuvendit, zyrtari përgjegjës, mysafiri i lartë në Kuvendin e Kosovës e bën Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Rregulla 15 (Të dhënat sipas kërkesës)

1. Mediat mund të kërkojnë me shkrim, në raste të veçanta gojarisht, nga Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun të dhëna dhe materiale, që nuk gjenden në faqen e internetit të Kuvendit të Kosovës.
2. Në rastet kur Zyra nuk është në gjendje, brenda ditës, t'i ofrojë të dhënat dhe materialet e kërkuara, e njofton median, për datën dhe për kohën e ofrimit.
3. Zyra, në rastin e refuzimit të kërkesës, për shkaqe ligjore, e njofton redaksinë e medias, me shkrim.

Rregulla 16 (Qasja në dokumentacionin zyrtar dhe në lëndën arkivore)

1. Qasja në dokumentet zyrtare dhe në lëndën arkivore të Kuvendit, në bazë të kërkesës së paraqitur me shkrim, u lejohet: gazetarëve të akredituar dhe të paakredituar, përfaqësuesve të organizatave joqeveritare, personave juridikë dhe fizikë, në përputhje me dispozitat ligjore.
2. Materialet e punës së trupave të punës të Kuvendit u shpërndahen përmes postës elektronike mediave të akredituar para mbajtjes së takimit.
3. Lejen për qasje në dokumentet zyrtare dhe në lëndën arkivore të Kuvendit e jep Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, me pëlqimin paraprak të sekretarit të Kuvendit, në afat prej pesë ditësh nga data e paraqitjes.

Rregulla 17 (Faqja e internetit)

1. Puna transparente e Kuvendit të Kosovës realizohet nëpërmjet faqes së internetit.
2. Faqja e internetit përmban:
 - a) Transkriptimin e seancave plenare, të mbledhjeve të Kryesisë dhe të komisioneve parlamentare, përfshirë edhe rezultatin e votimit;
 - b) Transmetimin online të seancave plenare (ueb streaming) dhe arkivimin e tyre;
 - c) Procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit;
 - ç) Procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve parlamentare;
 - d) Pyetjet parlamentare dhe mocionet me përgjigjet përkatëse;
 - dh) Kushtetutën, ligjet e miratuara, rezolutat, deklaratat, vendimet, Rregulloren e punës të Kuvendit dhe propozimligjet;

e) Njoftimet për seancat plenare, mbledhjet e Kryesisë së Kuvendi, mbledhjet e komisioneve parlamentare, si dhe mbledhjet e trupave të tjerë të Kuvendit,

ë) Njoftimet për aktivitetet ndërkombëtare të Kuvendit të Kosovës dhe për aktivitetet lidhur me procesin e integrimi evropian,

f) Kalendarin e ngjarjeve, komunikatat për shtyp, fotogalerinë, njoftimet për akreditimin, pyetjet më të shpeshta të shtypit dhe përgjigjet për to, si dhe hollësitë e kontakteve të përfaqësuesve të Kuvendit të Kosovës dhe

g) Publikimet e ndryshme dhe revistën "Kuvendi", e publikuar në gjuhët: shqip, serbisht, turqisht dhe anglisht (në formatin PDF).

2. Grupet parlamentare dhe deputetët

Rregulla 18 (Veçantitë e komunikimit)

1. Grupet parlamentare, deputetët dhe stafi i grupeve parlamentare, mund të komunikojnë në mënyrë të pavarur me mediat. Ata, në mënyrë të pavarur e zgjedhin, e përgatisin dhe e zbatojnë formën e komunikimit me mediat.
2. Grupet parlamentare, krahas kësaj Rregulloreje, i ndjekin rregullat e tyre të brendshme dhe marrëveshjet e arritura në grupin parlamentar.
3. Grupet parlamentare dhe deputetët mund t'i dërgojnë ftesat për konferencat e shtypit dhe njoftimet e shtypit me anë të e-mailit të Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.
4. Grupet parlamentare dhe deputetët, në mënyrë të pavarur, njoftojnë për aktivitetet mediale, për shërbimin në tryezën e pritjes dhe për Shërbimin e Sigurisë së Kuvendit dhe e sigurojnë mbajtjen e rendit në korridoret para zyrave të grupeve parlamentare.

3. Stafi i Kuvendit

Rregulla 19 (Përgjegjësitë në fushën e transparencës)

1. Stafi i Kuvendit është i detyruar ta procedojë në Zyrën për Media dhe Marrëdhënie me Publikun çdo pyetje ose kërkesë të bërë me shkrim nga mediat.
2. Informatën, për punën e Kuvendit ose të komisionit parlamentar, në formë njoftimi ose deklarate për shtyp, mund ta përgatisë dhe ta shpërndajë në mënyrë të pavarur edhe zyrtari kompetent i Kuvendit, pas njoftimit paraprak të Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun dhe pas pëlqimit paraprak të sekretarit të Kuvendit.
3. Stafi përgjegjës i Kuvendit, materialin e kërkuar nga Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, për t'iu përgjigjur pyetjeve të mediave, duhet ta sigurojë brenda ditës, deri në fund të orarit të punës.

4. Stafii, në rastet, kur për shkaqe objektive nuk është në gjendje t'i sigurojë materialet e kërkuara, sipas paragrafit 3 të kësaj rregulle, është i detyruar ta njoftojë Zyrën për Media dhe Marrëdhënie me Publikun për shkaqet e vonësës dhe për kohën kur mund ta ofrojë materialin ose për pengesat e mundshme ligjore.
5. Stafii i Kuvendit të Kosovës, që nuk është i punësuar në grupet parlamentare, në raste të veçanta mund të japë deklarata publike, pasi të jetë njoftuar paraprakisht Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun dhe pasi ta ketë dhënë pëlqimin sekretari i Kuvendit.
6. Çdo vit Kryesia përcakton shumë të caktuar buxhetore me qëllim të përmbushjes së punës publike dhe transparente të organeve dhe të trupave të Kuvendit.

4. Mediat

Rregulla 20 (Përfaqësuesit e mediave)

1. Përfaqësuesit e mediave janë të detyruara t'i zbatojnë dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe rendin e rregullin në Kuvendin e Kosovës.
2. Ta respektojnë funksionin kushtetues - ligjor dhe reprezentativ të Kuvendit, të organeve dhe trupave të tij.
3. Ta respektojnë integritetin e personalitetit të deputetëve, të stafit dhe të mysafirëve të Kuvendit.
4. Mos ta pengojnë, në asnjë mënyrë, punën dhe aktivitetin e Kuvendit, të organeve dhe të trupave të tij punës.
5. Të regjistrohen në listën e pjesëmarrësve, në mbledhjet e komisioneve parlamentare, në ngjarjet e tjera publike dhe në konferencat për shtyp, kur një listë e tillë është shpërndarë për regjistrim.
6. Ta prezantojnë veten dhe median, për të cilën punojnë, kur parashtrojnë pyetje, në konferencën për shtyp dhe pas deklaratës publike.
7. Mos të lëvizin nëpër tavolinat e deputetëve, në sallën e seancës plenare të Kuvendit.
8. Mos t'i përdorin pajisjet e Kuvendit, në sallën e gazetarëve, për qëllime private.
9. T'u binden informatave dhe udhëzimeve të zyrtarëve të Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, lidhur me kufizimin ose me përjashtimin e publikut në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.
10. T'u binden udhëzimeve, që janë në përputhje me këtë Rregullore, të Shërbimit të Sigurimit të Kuvendit.

Rregulla 21 (Hapësirat e punës për mediat)

Hapësirat për punën e mediave në Kuvend janë:

1. Salla e gazetarëve, që gjendet në katin përdhes, në të majtë të hyrjes kryesore të Kuvendit,
2. Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, dhomat N-07, N-08 dhe N-09, në katin përdhes, para hyrjes në hollin e Kuvendit.

Rregulla 22 (Orari i punës së mediave në hapësirat e Kuvendit)

1. Kur nuk ka zhvillim të aktiviteteve formale në Kuvend, përfaqësuesit e akredituar të mediave mund të jenë të pranishëm në hapësirat e punës, prej fillimit të orarit të punës deri në orën 16.00.
2. Kur janë duke u zhvilluar aktivitete formale në Kuvend, përfaqësuesit e mediave mund të jenë të pranishëm në hapësirat e punës, dy orë pas përfundimit të ngjarjes, në rastet kur ngjarja përfundon para orës 21, dhe një orë pas përfundimit të ngjarjes, kur ngjarja përfundon pas orës 21.00.
3. Jashtë orarit të punës së rregullt, qasja e përfaqësuesve të mediave në hapësirat e Kuvend, lejohet vetëm me ftesë të posaçme.
4. Ditëve të vikendit dhe ditëve të festave, mediat mund të kenë qasje në hapësirat e Kuvendit, me njoftim paraprake të Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me publikun, së paku një ditë pune para vikendit ose festës.

Rregulla 23 (Rendi në hapësirat e Kuvendit)

1. Përfaqësuesit e mediave hyjnë në ndërtesën e Kuvendit në hyrjen kryesore dhe dalin nga ndërtesa përmes daljes kryesore. Ata, së pari lajmërohen në tryezën e pritjes, në hyrje të Kuvendit, e pastaj i nënshtrohen kontrollit të sigurisë, duke i përfshirë edhe të gjitha pajisjet e tyre të punës.
2. Pajisjet e nevojshme të përfaqësuesve të mediave mund të vendosen në sallën për gazetarë dhe në Zyrën për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.
3. Objektet e mëdha e të panevojshme, veshjet e dimrit, aparatet dhe pajisjet e tjera të panevojshme duhet të mbahen në mjedise të veçanta, brenda ndërtesës së Kuvendit, sipas udhëzimeve të Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.
4. Në restorantin e Kuvendit nuk lejohen videoincizimi dhe fotografimi.
5. Xhirimet dhe fotografimet në mjediset e caktuara, jo si zona për të raportuar, mund të bëhen vetëm me pëlqimin paraprak të Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.
6. Zyra e kryetarit të Kuvendit, e nënkryetarit të Kuvendit, e kryetarit të komisionit, e sekretarit të Kuvendit, mund të përdoren për deklaratat, intervista, xhirime, fotografime, vetëm pas marrëveshjes paraprake me Kabinetin e Kryetarit të Kuvendit dhe me Zyrën për Media dhe Marrëdhënie me Publikun. Ndërsa, zyra e udhëheqësit të grupit parlamentar dhe e deputetit, mund të përdoret, pas marrëveshjes paraprake me përfaqësuesin e grupit parlamentar dhe me deputetin përkatës.
7. Mediat nuk mund të hyjnë në shërbimet e administratës së Kuvendit pa marrëveshje paraprake me Zyrën për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.
8. Nuk lejohen regjistrimi dhe fotografimi, para zyrës së grupit parlamentar. Regjistrimi mund të lejohet, në raste të veçanta, pas marrjes së pëlqimit paraprak, nga përfaqësuesi i grupit parlamentar, kur nuk pengohen lëvizjet e deputetëve dhe të stafit.

9. Nuk lejohen regjistrimi dhe fotografimi para sallës, ku mbahen takimi ose biseda e mbyllur për publikun. Në këtë rast lejohen, fotografimi para fillimit të takimit dhe regjistrimi i arritjes së deputetëve dhe të ftuarve të tjerë.
10. Përjashtimisht, nga paragrafi paraprak i kësaj rregulle, nuk lejohen fotografimi dhe regjistrimi i ardhjes së deputetëve dhe i të ftuarve të tjerë, në seanca dëgjimore të Komisionit për Punë të Jashtme për përzgjedhjen e ambasadorëve.

Rregulla 24 (Sigurimi i kushteve për përfaqësuesit e mediave të jashtme)

1. Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun i ofron të gjitha kushtet, që i ka në dispozicion, për punën normale të përfaqësuesve të mediave të jashtme në Kuvendin e Kosovës.
2. Përfaqësuesve të mediave të jashtme iu garantohen të njëjtat kushte sikurse mediave vendore.
3. Përfaqësuesit e mediave të jashtme mund t'i përdorin për komunikim mjetet e Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Rregulla 25 (Akreditimi)

1. Sekretari i Kuvendit, me propozimin e Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, e bën akreditimin e përfaqësuesve të mediave në Kuvendin e Kosovës.
2. Kërkesën për akreditim e bën redaktori i medias, ndërsa gazetari i pavarur kërkesën për akreditim e bën vetë.
3. Llojet e akreditimit:
 - a) akreditimi i përhershëm, për tërë legjislaturën në vijim;
 - b) akreditimi i përkohshëm, njëvjeçar;
 - c) akreditimi njëditor.
4. Llojin e akreditimit dhe numrin e gazetarëve, të xhiruesve dhe të fotografëve, për çdo medie, me propozim të Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, i përcakton sekretari i Kuvendit.
5. Media e jashtme mund të ketë korrespondent të përhershëm, të akredituar në Kuvendin e Kosovës. Për akreditimin e mediave të jashtme, paraprakisht zhvillohen konsultime me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës.
6. Gazetari i lirë (freelance) mund të akreditohet vetëm përkohësisht.
7. Akreditimet e përhershme dhe të përkohshme bëhen pas dorëzimit të formularit për akreditim, i plotësuar, i nënshkruar dhe i vulosur nga redaktori i medias. Gazetari i lirë duhet ta vërtetojë statusin e tij.
8. Përfaqësuesit e mediave, formularët nga paragrafi paraprak, mund t'i marrin dhe t'i dorëzojnë në Zyrën për Media dhe Marrëdhënie me Publikun. Ndërkaq, për akreditim "NJËDITOR", formulari dorëzohet në tryezën e pritjes në hyrje të Kuvendit.
9. Sekretari i Kuvendit, me propozimin e Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, në rastet e shkeljes së dispozitave të kësaj Rregulloreje, ose të shkeljes së rendit në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, mund ta tërheqë

akreditimin e dhënë, para skadimit të afatit. Në këtë rast, njoftohet me shkrim redaksia e medias.

10. Tërheqja e akreditimit, nga paragrafi paraprak i kësaj rregulle, mund të jetë e përkohshme ose e përhershme.

Rregulla 26 (Karta identifikuese e akreditimit)

1. Karta identifikuese e akreditimit është personale dhe e patransferueshme.
2. Kartat identifikuese të akreditimit i jep Zyra e Sekretarit të Kuvendit.
3. Llojet e kartave të identifikimit të akreditimit:
 - a) Karta e akreditimit të përhershëm: ka ngjyrë të verdhë, e përmban fotografinë, emrin dhe mbiemrin e plotë të zotëruesit, emrin e medias dhe shënimin "PRESS" për gazetarët, kurse shënimin "FOTO" për fotografët dhe xhiruesit.
 - b) Karta e akreditimit të përkohshëm: ka ngjyrë të verdhë dhe i përmban të gjitha të dhënat e akreditimit të përhershëm, duke ia shtuar edhe shënimin "NJËVJEÇAR".
 - c) Karta e akreditimit njëditor: ka ngjyrë të verdhë, me shënimin "NJËDITOR".
4. Dorëzimin e kartave identifikuese të akreditimit e bën Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun. Në rastin e akreditimit "NJËDITOR", dorëzimin e kartave identifikuese e bën stafi i tryezës së pritjes, në hyrje të Kuvendit të Kosovës.
5. Pas përfundimit të legjislaturës dhe pas përfundimit të afatit për të cilin është dhënë, karta e akreditimit duhet t'i kthehet Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.
6. Redaksitë e mediave të akredituara, për çfarëdo ndryshimi të statusit të përfaqësuesve të saj, duhet ta njoftojnë me shkrim Zyrën për Media dhe Marrëdhënie me Publikun. Të njëjtën gjë duhet ta bëjë edhe Shoqata e Pavarur e Gazetarëve të Kosovës, për gazetarët e pavarur.
7. Përfaqësuesi i mediave të akredituara, që e ndërron redaksinë ose i pushon marrëdhënia e punës, është i detyruar t'ia kthejë kartën e akreditimit Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.
8. Përfaqësuesit e mediave me akreditim njëditor, që i marrin kartat e tyre të identifikimit me rastin e hyrjes në ndërtesën e Kuvendit, duhet t'i dorëzojnë ato, në të njëjtin vend, në të njëjtën ditë, para se të dalin nga ndërtesa e Kuvendit të Kosovës.
9. Në rastet, kur veprohet sipas rregullës 25.9, kur tërhiqet akreditimi para kohe, përfaqësuesi i medias dhe gazetari i pavarur është i detyruar ta kthejë kartën e akreditimit në Zyrën për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

KREU IV (DOKUMENTARI)

Rregulla 27 (Xhirimet dhe incizimet për nevojat e Kuvendit)

1. Seanca plenare e Kuvendit xhirohet dhe incizohet për nevojat: e deputetëve, të shërbimeve profesionale dhe të dokumentarit.
2. Incizimin tonik të seancës plenare e bën shërbimi profesional i Kuvendit.

Rregulla 28

1. Xhirimi dhe incizimi i mbledhjeve të trupave të punës të Kuvendit bëhet sipas nevojës.
2. Incizimi tonik i mbledhjeve të trupave të punës bëhet domosdo, kur këtë e kërkon kryetari i trupit të punës.

Rregulla 29

1. 1 Seancat solemne, fjalimet e personaliteteve të larta, mysafirë në Kuvend dhe ngjarjet e tjera të shënuara, xhirohen dhe incizohen.
2. Të gjitha incizimet dhe xhirimet, sipas KREUT III, ruhen në Arkivin e Kuvendit.

KREU V (DISPOZITAT E VEÇANTA DHE PËRFUNDIMTARE)

Rregulla 30 (Rastet e jashtëzakonshme)

Sekretari i Kuvendit, në rastet e jashtëzakonshme, mund të vendosë rregulla të tjera, të bazuara në ligj dhe në Rregulloren e Kuvendit pa rënë ndesh me lirinë e mediave.

Rregulla 31 (Ndryshimet dhe plotësimet)

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje, bëhen me procedurë të njëjtë, sikurse në rastin e nxjerrjes së saj.


Rregulla 32 (Hyrja në fuqi)

Rregullorja hynë në fuqi tetë ditë pas nënshkrimit dhe pas publikimit në tabelën e njoftimeve në Kuvendin e Kosovës dhe në faqen e internetit.

Nr. 04-V-024

Prishtinë, 19 prill 2011

Kryetari i Kuvendit


Dr. Jakup KRASNIQI